

1 E mërkurë, 26 qershor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
8 seancës, të lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
13 Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi disa
15 gjëra për të sqaruar përpara sesa të fillojmë. Dua që t'ju
16 kujtoj të gjithëve që të hënën do të fillojmë në orën 10.00
17 dhe jo si zakonisht në orën 9.00. Ndërkohë që pjesa tjetër e
18 programit do të jetë ekzaktësisht e njëjta siç është çdo ditë.

19 Sot paradite do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitar të
20 Prokurorisë me numër 04474.

21 Përpara sesa të fillojmë me dëshmitarin, dëshiroj t'i
22 kërkoj Prokurorisë të na japë shpjegime sa i takon Dëshmitarit
23 04445.

24 E di që na thatë përmes një njoftimi që do të na njoftoni
25 deri në orën 2.00. Megjithatë, nuk mjafton ky shpjegim sepse

1 duam që të kemi një përgjigje përfundimtare më herët.
2 Maksimumi që mund të tolerojmë është deri në orën 11.00 sot
3 paradite. Kështu që ju lutem merrni vendimin dhe na thoni deri
4 në orën 11.00 sepse na duhet ta dimë deri në orën 11.00. Nuk
5 ju tolerojmë dot që të vazhdoni të jepni shpjegimin deri në
6 orën 2.00.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. E kuptuam, i nderuar
8 Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Palët janë
10 gati për të filluar? Keni ndonjë çështje për të trajtuar
11 përpara sesa të fillojmë? Duket se jo.

12 Në rregull, atëherë, Asistente e seancë, ju lutem silleni
13 dëshmitarin në seancë.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
18 z. Fondaj.

19 DËSHMITARI: Z. Kryesues, po, mirë po ju dëgjoj.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Dëshmitar, sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që
22 t'i përgjigjeni pyetjeve. Mundohuni që t'i përgjigjeni
23 pyetjeve qartë, me fjali të thjeshta. Në qoftë se nuk e
24 kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkonit avokatit ose
25 palëve të tjera që të përsërisin pyetjet ose thoni që nuk e

1 kuptoni pyetjen dhe palët do të përpiqen që t'ja u sqarojnë
2 atë.

3 Po ashtu ju lutem na thoni bazën e njohurive mbështetur
4 në të cilën ju do të jepni përgjigjet tuaja. Ju kujtohet që
5 jeni ende nën detyrimin për të thënë të vërtetën siç e keni
6 deklaruar në betimin solemn.

7 Nëse kërkonit që të bëhen pushime, ju lutem na e thoni
8 këtë gjë, dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse.

9 Tani do të vazhdojmë me pyetjet. Gjykatësi Mettraux ka
10 ende disa pyetje, ndërkohë edhe disa persona të tjerë në sallë
11 do të kenë pyetje pas tij.

12 Keni një pyetje? Dëshironi të thoni diçka, Dëshmitar?

13 DËSHMITARI: Zoti Kryesues i Panelit Gjyqësor, unë dje
14 pasdite i kam parë incizimet që janë prezantuar nga Gjykata. I
15 kam përcjellë me vëmendje dhe sidomos marrjen në pyetje nga
16 Gjyqtari. Më ka bo me mendue që me kërkuje ni avokat,
17 respektivisht, një mbështetje nga një avokat se po mendoj se
18 jam keqpërdor.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni
20 përpjekur që të kontaktoni me një avokat vetë ju,
21 personalisht?

22 DËSHMITARI: Jo, unë po e kërkoj prej juve të ma ofroni
23 ndihmën e një avokati.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të duhet
25 të bëjmë një pushim të shkurtër të diskutojmë këtë çështje. Do

1 të bëjmë një pushim prej pesë minutash. [Mikrofoni
2 çaktivizuar].

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 --- Seanca ndërpritet në orën 09.06

5 --- Seanca rifillon në orën 09.18

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Erdha për të
7 thënë se do të bëjmë sërish një pushim. Atëherë po sigurohemi
8 që dëshmitari të takohet me Zyrën e Mbrojtjes së Dëshmitarëve
9 dhe me Zyrën Administrative. Do të marrim një raport edhe
10 pastaj vendosim sesi do të vazhdojmë më tej.

11 Do të bëjmë pushim deri në orën 10.00, dhe na kanë thënë
12 që deri në orën 10.00 do të jetë kohë e mjaftueshme për të
13 ditur se çfarë plani do të kemi. Kështu që do të bëjmë pushim
14 deri në orën 10.00. Shihemi përsëri në orën 10.00.

15 --- Seanca ndërpritet në orën 09.19

16 --- Seanca rifillon në orën 10.02

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
18 uleni.

19 Ju lutemi sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Fondaj, e
22 kuptojmë që keni biseduar me Zyrën Administrative dhe keni
23 shprehur shqetësimet tuaja, dhe ne i kuptojmë shqetësimet
24 tuaja.

25 Tani unë do t'u përgjigjem disi shqetësimeve tuaja.

1 Arsyet që -- kur -- domethënë -- kur -- që të caktojmë një
2 avokat ne për dëshmitarin, duhet të ketë arsye të forta, që
3 dëshmitari mendon se po inkriminon veten, mendon se po e
4 akuzojnë se është kryerësi i një krimi. Nuk është rasti ynë.
5 Në asnjë moment nuk është ngritur ndonjë pretendim i një
6 personi, i nderuar, askush nuk ka pretenduar që keni kryer
7 krim, apo që jeni përgjegjgur në ndonjë formë që të -- t'ju
8 ketë inkriminuar në ndonjë formë.

9 Po ashtu jeni shqetësuar për pyetjet e Gjykatësve. Sipas
10 Rregullores sonë, Gjykatësit mund t'u drejtojnë pyetje
11 dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor. Ju jeni këtu thjesht për
12 të thënë të vërtetën, për t'iu përgjegjgur pyetjeve, me aq sa
13 mundeni.

14 Ne e kuptojmë që është stresuese kjo situatë, dhe ne e
15 vlerësojmë faktin që keni ardhur dhe që po bëni të pamundurën.

16 Ne do të vazhdojmë, ne kemi edhe disa pyetje, dhe
17 shpresojmë që të mbarojmë sa më shpejt në mënyrë që të
18 largoheni. Kështu që kërkesa juaj për një avokat në këtë
19 moment rrëzohet.

20 E kuptuat këtë, z. Fondaj?

21 DËSHMITARI: Po, zoti Kryetar.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe shumë
23 faleminderit që keni ardhur dhe faleminderit që u jeni
24 përgjegjgur pyetjeve, dhe me Zyrën Administrative, dhe ata
25 shprehin mirënjohjen e tyre.

1 Tani do të vazhdojmë me pyetjet. Do të vazhdojë Gjykatësi
2 Mettraux me pyetjet e veta.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
4 Smith.

5 DËSHMITARI: Kurtesh Fondaj [Vijon]

6 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdim]

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe mirëmëngjesi, z.
8 Fondaj.

9 PË. Mirëmëngjesi, z. Gjykatës.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt, më kanë mbetur
11 edhe pak pyetje për ju, kështu që do isha mirënjohës në qoftë
12 se do t'i përgjigjeshit këtyre pyetjeve sa më shkurt të
13 mundeni dhe me -- sa më sinqerisht të mundeni, siç keni bërë
14 edhe dje.

15 Tani, do kërkoj që të shikojmë një provë materiale së
16 bashku. Dua që të paraqitet në ekran, dhe i kërkoj Sekretarit
17 ta paraqesë në ekran -- që është prova P1106, e pastaj do ju
18 kërkoj, do ju them unë arsyen se pse duhet ta shohim këtë
19 dokument bashkë.

20 I lutem Sekretarit që të kaloni pak më poshtë në tekstin
21 në shqip.

22 Z. Fondaj, a ju kujtohet që e patë këtë dokument, që ua
23 tregova këtë dokument -- që ua tregova këtë dokument dje?

24 PË. Po, dje e kam pa këtë dokument.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky është një dokument që

1 na u soll në vëmendje të zotit -- nga Avokati i z. Thaçi, dhe
2 na u tha dje që ka një problem përkthimi në versionin në
3 anglisht. Ne kontrolluam tekstin, dhe do pyesim për pak në
4 qoftë se është bërë verifikimi zyrtar përkatës, por tani do ju
5 kërkoja që të lexonit këtë pjesën në tekst që thuhet që:

6 "Nga ajo Prokurori kërkohet ...".

7 Ju lutem, lexojeni me zë, në mënyrë të tillë që të na
8 përkthehet ne në anglisht. Lexojeni këtë pjesën me zë,
9 Dëshmitar.

10 PË. "Nga ajo Prokurori kërkohet të urdhërojë zbatimin e
11 hetimeve në zgj -- në lidhje me këtë çështje penale."

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit
13 edhe z. Misetic që na e solli në vëmendje këtë gjë.

14 A pajtoheni me mua, Dëshmitar, se kjo sugjeron që z.
15 Limaj, që e ka shkruar këtë kërkesë, i kërkon Prokurorisë që
16 të urdhërojë hapjen ose çeljen e hetimeve?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Kundërshtojmë me pyetjen, sepse ky -
18 - mënyra se si u formulua pyetja është kjo që:

19 "Kjo sugjeron që z. Limaj, që e ka shkruar këtë dokument,
20 kërkon etj. etj."

21 Domethënë, është një dokument i cili thjesht thotë që ky
22 është një dokument që është shkruar nga Fatmir Limaj, po
23 ndërkohë nuk e dimë në qoftë se ky është rasti apo jo.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Fondaj, pyetja është
25 kjo: Duke e parë dokumentin kështu siç është, a pajtoheni me

1 mua që autori që pretendohet ta ketë shkruar këtë dokument, z.
2 Limaj, i kërkon -- ose kërkon Prokurorisë që të hapen hetimet?
3 A e lexoni edhe ju si unë, domethënë a pajtoheni me mua që ky
4 është interpretimi i kësaj pjese që ju sapo lexuat, që z.
5 Limaj kërkon nisjen e hetimeve lidhur me këtë çështje.

6 PË. Zoti Kryesues i Panelit Gjyqësor, kisha kërkuar që të më
7 kursenin nga këto çështje se, së pari, për mua dokumenti nuk
8 është valid, dhe nuk mban nënshkrimin e personit për të cilin
9 po flisni. Kështu që për mua është dokument i dyshimtë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thjesht po ju pyes në
11 qoftë se shkruhet kështu në këtë dokument apo jo. Domethënë, a
12 sugjerohet prej dokumentit kjo që sapo thashë dhe kërkoj që të
13 jepni përgjigje po apo jo.

14 PË. Nuk du të -- nuk mundem të prononcohem në këtë çështje
15 se nuk kam njohuri, edhe realisht nuk i di se cila është baza
16 ligjore që është thirr dhe dokumentin e tillë, respektivisht,
17 rregulloren për të cilën po flasim, unë s'e kam pas në dorë,
18 dhe nuk e di a është e shkruar konform saj.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do ju bëj një
20 tjetër pyetje atëherë. A do ishte e drejtë të sugjerohej se
21 nga fundi ose mesi i shtatorit dhe në tetor, zona e Pashtrikut
22 ka kaluar një proces riorganizimi? A pajtoheni me mua lidhur
23 me këtë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju sugjeroj disa

1 faktorë që mund të kenë luajtur ndikim mbi procesin e
2 riorganizimit të zonës së Pashtrikut. Dhe më pas do ju pyes që
3 në qoftë se, sipas mendimit tuaj, vërtetë këto kanë qenë
4 faktorë që kanë çuar në riorganizim, ose në qoftë se mendoni
5 që ka pasur faktorë të tjerë që kanë çuar në riorganizim. Kam
6 katër faktorë. Do t'ua them pastaj do ju kërkoj që t'i
7 komentoni.

8 Faktori i parë është ai që keni përmendur edhe ju më
9 herët, që është ofensiva serbe ose jugosllave në zonë. Faktori
10 i dytë, që përsëri e keni përmendur, është fakti që disa
11 anëtarë të UÇK-së u tërhoqën. Disa prej tyre shkuan në
12 Shqipëri. Faktori i tretë është fakti që ushtarë të caktuar të
13 UÇK-së, përfshirë këtu edhe Ismet Jasharin, Kumanovën, janë
14 vrarë gjatë periudhës së verës, dhe pastaj së fundi: Në mes të
15 tetorit të vitit 1998 u nënshkrua marrëveshja ndërmjet Holbook
16 dhe Milosheviçit, që kërkonte ndryshimin e situatës në terren.

17 A pajtoheni me mua që këto kanë qenë faktorët kryesorë që
18 kanë çuar në ristrukturimin e zonës së Pashtrikut në atë kohë?
19 PË. Në princip, po. Ndoshta duhet me shtu edhe një që mendoj
20 që është gjithashtu e rëndësishme. Kemi të bëjmë humbjen e
21 njerë -- e jetëve njerëzore edhe civile, të person --
22 domethënë, të njerëzve civilë, edhe shkatërrimin në total,
23 domethënë, në tërësi të të mirave materiale të popullatës në
24 komunën e Suharekës.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon humbjes së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 10

1 jetëve, a është e saktë se Ismet Jashari është vrarë më 26
2 tetor [Sipas përkthimit] të vitit 1998, ose rreth asaj
3 periudhe. A do ishte e saktë që të thuhet kjo? Më 26 gusht, më
4 falni, 1998. A është e saktë, pak a shumë kjo periudhë?
5 PË. Mundet me qenë e saktë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në atë kohë, ai ka qenë
7 zëvendëskomandanti i Brigadës 121?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai në atë periudhë, pra si
10 zëvendës komandant i Brigadës 121, është zëvendësuar nga Haxhi
11 Shala. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Nuk i di detajet. Për sa i përket Brigadës 121 nuk i di.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini që Haxhi Shalaj
14 është nipi i Fatmir Limës?

15 PË. Nuk e di.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se çfarë roli ka
17 pasur Haxhi Shala përpara se sa të bëhej zëvendëskomandant i
18 Brigadës 121?

19 PË. Haxhi Shalën për herë të parë e kam parë në -- ose jemi
20 taku me të në sh -- me nëntor, kur kemi raportue, kur jemi
21 taku në -- që kemi -- në takimet që kemi pas me Shtabin,
22 drejtorinë operative të Shtabit të Përgjithshëm me Sali
23 Veselin. Paraprakisht, çfarë funksionesh, si ka ardhë në krye
24 të komandës Brigadës 121, nuk e di.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do i kërkoja

1 tani Sekretarisë tani të paraqesë provën materiale P1332. Këtë
2 dokument e kemi parë edhe më herët. Besoj se ju kujtohet,
3 Dëshmitar, apo jo? Është një prej dokumenteve tuaja. Kam dy
4 pyetje plotësuese lidhur me këtë dokument.

5 Pyetja e parë është kjo: A ju kujtohet që -- a e njihni
6 këtë dokument, e keni parë më përpara këtë dokument,
7 Dëshmitar?

8 PË. Është, z. Gjykatës, dokumenti është e vërtetë që është e
9 shkruar nga unë, por nuk është burimi që është marrë nga unë.
10 Në Prokurori ky dokument ka ardh në të tjera rrugë, jo nga ana
11 jeme. Por megjithatë, dokumenti është i imi.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dy pyetje plotësuese.
13 Pra, përveç pyetjeve që ju kanë bërë dje lidhur me këtë
14 dokument. Në qoftë se e dini përgjigjen, më thoni se cila
15 është përgjigja. Në qoftë se nuk e dini, thoni që nuk e di.

16 Pyetja e parë është kjo: A ju kujtohet që të keni marrë
17 një përgjigje ndaj kësaj kërkesë që keni bërë ju? Pra,
18 sugjerohet që ky është një kërkesë që ju e keni dërguar më
19 datë 10 nëntor. A ju kujtohet nëse keni marrë ndonjë përgjigje
20 për këtë kërkesë që keni hartuar ju asa -- në atë kohë --
21 asokohe, Dëshmitar?

22 PË. Nuk e di.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A dini në qoftë se ka
24 marrë një përgjigje Drini?

25 PË. Nuk e di.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personi që përmendet në
2 këtë dokument, pra personi që erdhi për të kërkuar një kerr,
3 është Ukë Gegaj. Besoj se na e thatë dje që ju e kuptuat që ai
4 të ishte anëtar -- e kishit kuptuar që ai ishte anëtar i
5 policisë ushtarake. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. E saktë.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do ishte e drejtë të
8 thuhej që në fakt ai ishte komandanti i skuadrës, të skuadrës
9 së parë të Brigadës 121, domethënë, të policisë ushtarake të
10 Brigadës 121? Është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Sipas njohurive të mia, ka qenë komandanti i policisë
12 ushtarake në Brigadën 121.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa për sqarim lidhur me
14 këtë pikë, a e njihni fshatin Bellanicë, keni dëgjuar për këtë
15 fshat? E njihni këtë fshat?

16 PË. Po, e njoh.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky fshat gjendet në veri
18 të Suharekës. Kështu, dëshmitar?

19 PË. Gjendet në veri-lindje të Suharekës.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse është e nevojshme që
21 të shikoni hartën që na e shënjuat dje, mund ta paraqesim.
22 Por, në qoftë se nuk ju nevojitet, a kam të drejtë unë që them
23 që Bellanica i takon që ka qenë pjesë e përgjegjësisë së
24 Brigadës 121? A është e drejtë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po, vetëm edhe një sqarim. Thashë në veri-lindje. Gabim.

1 Në veri-perëndim është fjala.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

3 Kam një grup të fundit pyetjesh për ju, Dëshmitar. Dje e
4 kuptova që ju thatë, dhe në qoftë se nuk e kam kuptuar siç
5 duhet, ju lutem ma thoni këtë gjë, por mua m'u krijua
6 përshtypja që ju thatë që keni treguar zonat ose brigadat
7 brenda zonës, ose zonave, që kanë kërkuar këshillat
8 profesionale nga Shtabi i Përgjithshëm ose nga anëtarët e
9 Shtabit të Përgjithshëm. A e kam kuptuar siç duhet, a e kam
10 kuptuar drejtë, Dëshmitar?

11 PË. Kërkoj edhe një herë të më jepet pyetja se nuk e kuptova.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Patjetër. Mund ta lexoj
13 atë çfarë keni thënë dje. Ndoshta do t'ju ndihmojë më shumë
14 kjo, por në versionin në anglisht juve thuhet të keni thënë
15 kështu, e po flisnit këtu për Drinin, për Ekrem Rexhën, dhe ti
16 thua si më poshtë:

17 "Unë gjithashtu thashë e kam qenë në pozitë që të
18 komunikoj çështje Shtabit të Përgjithshëm, sepse Shtabi i
19 Përgjithshëm mund t'i jepte këshillim profesional."

20 A ju kujtohet ta keni thënë dje këtë, Dëshmitar?

21 PË. Jam aq konfuz sa me të vërtetë nuk e di a e kam thënë, a
22 s'e kam thënë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë do t'ua bëj
24 ndryshe pyetjen. Në nivel zone ose në nivel brigade, a
25 lejoheshit që kur e shikonit të nevojshme të kërkonit

1 këshillim profesional te Shtabi i Përgjithshëm, që mund të
2 ishte për shembull për çështje operative, për çështje
3 financash, për çështje logjistike? A mund ta bënit këtë gjë? A
4 mund të kërkonit këshillim profesional nga Shtabi i
5 Përgjithshëm, Dëshmitar?

6 PË. Po, sigurisht që po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë do ta bënit
8 përgjithësisht me shkrim apo e bënit me gojë? Apo e bënit edhe
9 me shkrim edhe me gojë? Si, si ndodhte ky kërkim këshillimi
10 prej Shtabit të Përgjithshëm, Dëshmitar?

11 PË. Nuk jam në detaje se kurrë nuk ju kam drejtu, as me gojë
12 e as me shkrim.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, për shembull, Drini
14 vetë, me sa dini juve, a ka kërkuar ndonjë lloj ndihme të
15 tillë, të kësaj natyre?

16 PË. Nuk e di.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
18 pyetje të tjera, Dëshmitar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe
20 Gjykatësi Gaynor ka disa pyetje për ju, Dëshmitar.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
22 Smith.

23 Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

24 PË. Mirëmëngjesi, z. Gjykatës.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua që të sqaroj disa

1 çështje të dëshmisë suaj. Së pari do të filloj me strukturat e
2 raportimit në policinë ushtarake. Pra para dhe pas krijimit të
3 komandës së zonës.

4 Së pari, a mund të na e sqaroni, Dëshmitar, se kur është
5 krijuar komanda e zonës së Pashtrikut?

6 PË. Zona -- komanda e zonës së Pashtrikut është krijuar në
7 fillim të dhjetorit të vitit 1998. Ndërsa komandanti i saj ka
8 ardh mbas datës 14 dhjetor, në funksionin e komandantit, pra
9 Ekrem Rexha. Kur ai ka ardh në këtë -- në funksion, në krye
10 dhe struktura komandës së zonës veç ka qenë e konstitume.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Të përqendrohemi te periudha
12 përpara krijimit të zonës -- së komandës së zonës. Duke u
13 përqendruar përpara kësaj periudhe, thjesht dhe shkurt dua që
14 të na shpjegoni se si ka qenë linja e raportimit për policinë
15 ushtarake brenda Brigadës, domethënë cila ishte -- cili ishte
16 zinxhiri i raportimit brenda brigadës? Pra, së pari, ata i
17 raportonin komandantit të brigadës së policisë ushtarake? Ose
18 ta bëj ndryshe pyetjen, fillimisht kujt i raportonin ata?

19 PË. Gjithsecila ndihmëskomandant në nivel të brigadës i ka
20 raportue komandantit të brigadës. Po flas çdo herë në fazën
21 kur unë kam qenë komandant, pra deri në dhjetor të vitit 1998.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur thoni komandant i
23 brigadës, e keni fjalën për komandantin e brigadës që ke qenë
24 vetë, apo e keni fjalën për komandantin e policisë ushtarake
25 brenda komandës së brigadës? Për kë e keni fjalën, Dëshmitar?

1 PË. Komandanti i policisë ushtarake ka marrë detyrat edhe i
2 ka për -- dhënë përgjegjësi komandantit të brigadës, cilës i
3 ka takuar. Rreth këtë rast po flas. Në Brigadën 123, sa kam
4 qenë unë komandant brigade, komandanti i policisë ushtarake ka
5 marrë detyrat edhe ka referue për punën e tij -- më ka referu
6 mue.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju kujt i raportoni, sa
8 i takon informacionit që merrni ju vetë nga policia
9 ushtarake, brenda Brigadës 123, Dëshmitar?

10 PË. Unë për çështje të caktme, nëse kam pas nevojë, i kam
11 komunikue Shtabit të Përgjithshëm në drejtori operative dhe ne
12 përmendëm kemi pas nja dy takime me -- të cilat i ka udhëheq
13 Sali Veseli.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Zakonisht a i raportoni
15 Sali Veselit sa i takon informacionit që merrni nga policia
16 ushtarake, Dëshmitar? Sigurisht, brenda kuadrit të Brigadës
17 123.

18 PË. Nuk kam pas specifika të caktme për të cilat unë kam pas
19 nevojë me raportu në atë periudhë.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse Shtabi i Përgjithshëm
21 dëshironte që të lëshonte një urdhër për policinë ushtarake,
22 për njësitë e policës ushtarake, brenda Brigadës 123, si
23 transmetohej ky urdhër? Domethënë, nga Shtabi i Përgjithshëm
24 deri te njësitet e policës ushtarake. Cila ishte rruga që
25 ndiqte urdhri?

1 PË. Çdo herë po flas për fazën kur unë kam qenë komandant i
2 Brigadës, urdhri është dash me më ardh mu, e unë pastaj me e
3 kthye në nivel të policisë ushtarake. Por nuk kemi pas raste
4 dhe nevojë, përndryshe kjo në këtë formë është dasht me
5 funksionu.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur i keni raportuar çështje
7 Sali Veselit, si i keni raportuar këto çështje. Domethënë,
8 çfarë metode komunikimi keni përdorur për transmetimin e
9 mesazheve për të?

10 PË. Kemi pas takime javore dhe në ato takime kemi referu,
11 kemi tregue për problematikat që ne i kemi pas në nivel të
12 Brigadës. Dhe specifike në këtë rast, a është fol diçka për
13 polici ushtarake, më duket se jo.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani kalojmë te periudha pas
15 krijimit të komanda -- komandës së zonës së Pashtrikut.

16 A mund të na shpjegoni, Dëshmitar, se cila ka qenë vija e
17 raportimit nga njësitet e policisë ushtarake brenda brigadave
18 deri te Shtabi i Përgjithshëm? Domethënë, cilat janë hapat e
19 ndryshme të ndjekur në këtë linjë ose vijë raportimi, nga
20 njësitet e policisë ushtarake, deri te Shtabi i Përgjithshëm?

21 PË. Po, ka pas një ndryshim për të cilin normale që ne disa
22 eprorë ushtarakë kemi dhënë vërejtje, dhe kemi insistu që
23 forma e komunikimit duhet të jetë ajo që ka ekzistue edhe në
24 para muajit dhjetor, por realisht, se sa -- çka ka qenë, tek
25 ka qenë, unë nuk e di, se nuk jam -- nuk kam pas të bëj me

1 problematikat specifike.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë, në provën P1327.6,
3 faqe 17 që është një prej pjesëve të intervistës që keni dhënë
4 për ZPS-në, ju keni diskutuar për Halil Qadrakun. Pyetja që ka
5 bërë Prokurori ishte kjo:

6 "A ka qenë Halit Qadraku shef i ZKZ-së të zonës operative
7 të Pashtrikut?

8 Përgjigja që jepni ju është "Po".

9 "PY. Kujt i ka raportuar ai në strukturën ushtarake?

10 "PË. Normalisht i ka -- është dashur që t'i raportojë
11 Ekrem Rexhës. Por e vërteta është që ai ka pas kontakte në
12 Shtabin e Përgjithshëm me Kadri Veselin."

13 Këtu po flasim për ZKZ-në, jo për policinë ushtarake. A
14 mund të na sqaroni, Dëshmitar, se nëse pas krijimit të
15 komandës së zonës së Pashtrikut policia ushtarake a pritej që
16 në nivel të parë t'i raportonin komandantit të brigadës dhe më
17 pas t'i raportonin komandantit të zonës së Pashtrikut? A ka
18 qenë kështu, dëshmitar? Kanë qenë këto hapat?

19 PË. Zoti Gjykatës, realisht nuk jam në rrjedha, dhe me thanë
20 të drejtën, nuk po më kujtohen saktë veprimet dhe çka do që
21 flas, mund dhe veç me bo huti, kështu që kisha kërkim të më
22 kurseni nga këto përgjigje.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ta bëj ndryshe pyetjen.
24 Kur keni qenë shefi i Shtabit të komanda -- të komandës së
25 zonës së Pashtrikut, ju keni qenë eprori i tretë më i lartë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 19

1 brenda komandës së zonës së Pashtrikut. A është e vërtetë kjo,
2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë rol tuajin, a e keni
5 kuptuar që një prej detyrave ose punëve të komandës së zonës
6 ishte që të merrte informacion nga policia ushtarake dhe t'ia
7 kalonte këtë informacion Shtabit të Përgjithshëm?

8 PË. Po deri sa ne - kam qenë në kuadër të zonës, në shumicën
9 e takimeve që kemi pas në nivel të komandës së zonës operative
10 të Pashtrikut. Është thirr edhe komandanti i kompanisë e
11 policisë, edhe ai ka qenë prezent në takime. Por zakoni -- pra
12 rregullisht, me sa di unë, ai ka referue dhe ka marrë detyra
13 nga komandanti Ekrem Rexha, respektivisht për çështje
14 organizative të momentit, të caktume edhe nga unë si shef
15 shtabi.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur thoni "komandanti i
17 njësisë ushtarake" deshët të thoshit "komandanti i njësisë së
18 policisë ushtarake"?

19 PË. Komandanti i kompanisë së policisë ushtarake në nivel
20 zone. Pra zona ka pas një kompani të policëve ushtarakë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Dua të flasim
22 sërish për ZKZ-në dhe të fokusohemi sërish në periudhën para
23 krijimit të komandës së zonës. Me fjalë të thjeshta, a mund të
24 na shpjegoni cila ka qenë linja e raportimit për njësitet e
25 ZKZ-së brenda brigadës? Nga brigada drejt Shtabit të

1 Përgjithshëm, cila ishte linja e raportimit?

2 PË. Qoftë marrja e detyrave, qoftë raportimi, të gjitha kanë
3 shkue përmes komandantit të brigadës.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Brenda brigadës suaj, ju a
5 kishit një komandant për ZKZ-në?

6 PË. Po. Atë -- ai ka qenë -- e detyra e tij ka qenë
7 ndihmëskomandant ose zëvendëskomandant për çështje të caktume.
8 Në këtë rast, për zbulim dhe kundërzbulim. Dhe ai normale që i
9 ka mbështet dhe e ka ndihmue komandantin për specifikat e
10 zbulimit dhe kundërzbulimit.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse ju personalisht, apo
12 ai, merrnit informacione të zbulimit dhe kundërzbulimit, të
13 rëndësishme, si siguroheshit ju që këto informata t'i
14 përcilleshin Shtabit të Përgjithshëm?

15 PË. Referimi ose përcjellja e informacionit ka shku nga
16 komandanti i brigadës, dhe ndoshta që ajo shkresa që juve ju
17 ka ra në dorë, për sa i përket raportimit të pozicioneve në --
18 të serbëve në territorin e komunës e Suharekës, pikërisht ka
19 të bëjë me q'këtë problematikë që ju jeni tuj e shtjellue.

20 Pra, e shpjegon saktë që raportimi ka shku nga unë e jo
21 nga -- drejtpërdrejtë nga personi që e ka -- që m'i ka referu
22 mue, për zbulim dhe kundërzbulim në nivel brigade. Domethënë,
23 ndihmëskomandanti, respektivisht komandanti për zbulim dhe
24 kundërzbulim më ka refer mue. Mbas kësaj unë e kam bërë një
25 raport, respektivisht një informatë, dhe e kam përcjellë

1 drejtorisë operative në Shtab të Përgjithshëm.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse shohim rrjedhën e
3 informacionit nga ana tjetër. Nëse ZKZ-ja në nivel të Shtabit
4 të Përgjithshëm dëshironte t'i transmetonte një urdhër
5 njësitit të ZKZ-së në Brigadën 123, si e bënin ata?

6 PË. Nuk e di. Po --

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me aq sa keni kuptuar jo, si
8 ishte struktura komanduese e ZKZ-së?

9 PË. Po, gjatë dëshmisë dje, pardje unë e kam përmend që
10 komandanti i brigadës ka marrë direktivat respektivisht,
11 urdhëresa, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Deri në
12 konstituim të zonës. Pastaj, çdo detyrë më anejna, komandantët
13 e brigadave i kanë marrë detyrat nga komandanti i zonës
14 operative, së cilës i ka takue, e jo nga resorët për zbulim
15 dhe kundërzbulim, apo ndonjë resor tjetër specifik. Por çdo
16 herë është shkue komunikimi përmes komandantit.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, tani të flasim për
18 periudhën pasi u krijua komanda e zonës së Pashtrikut, kam
19 nevojë që të sqarojmë raportimin e informacionit nga njësitet
20 e ZKZ-së brenda brigadës drejtë Shtabit të Përgjithshëm. Ju po
21 thoni që kalonte përmes komandantit të brigadës, i cili më pas
22 ja raportonte komandantit të zonës së Pashtrikut, i cili më
23 pas ja raportonte Shtabit të Përgjithshëm? Ky ishte rendi?

24 PË. Komandanti -- komandantët e brigadave raportonin në
25 drejtorinë operative të zonës operative, në këtë rast shefit

1 të shtabit. Shefi i shtabit i grumbullonte të dhënat, i
2 raportonte krye -- komandantit të zonës, e komandanti i zonës
3 pastaj vazhdonte në drejtim të Shtabit të Përgjithshëm. E
4 komandantët e brigadave normale që nuk kanë kontakti direkt me
5 komandantin e zonës, por me shefin e shtabit në nivel zone.
6 Pra, me mue kanë komunikuar.

7 Eventualisht, me zëvendëskomandantin e zonës operative.
8 Ndërsa pastaj përpilohej një raport prej atyne takimeve, dhe i
9 raportoj Ekrem Rexhës, respektivisht komandant Drinit, edhe
10 nëse kishte specifika të caktuar, ai komunikonte me Shtabin e
11 Përgjithshëm. E jo unë, apo zëvendëskomandanti.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Sqarojmë edhe
13 diçka tjetër. Kjo ka lidhje me batalionin special të Shtabit
14 të Përgjithshëm. Në fillim të dëshmisë suaj, bëtë disa shënime
15 në hartë, dhe treguat se ku ka qenë batalioni special i
16 Shtabit të Përgjithshëm, dhe thatë që operonte në Llanishtë.
17 Ishte i vendosur, pra, ishte i stacionuar në Llanishtë ky
18 batalion. Ju kujtohet, Dëshmitar?

19 PË. Llanishtë dhe Grejëçec. Bazën respektivisht komanda e ka
20 pas në Llanishtë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na -- a e
22 përshkruani pak më shumë mandatin e këtij njësi? Çfarë bënte
23 ky njësi, pse e kishte emërtimin komandant -- "batalioni
24 special i Shtabit të Përgjithshëm"?

25 PË. Ëh, realisht, cilat kanë qenë detyrat e këtij batalioni

1 në aspektin specifik, nuk e di, por vetëm e di për faktin ose
2 jam në rrjedhat e asaj se ka ekzistuar, dhe kush ka qenë
3 komandant dhe disa elementë i di sepse mua më më ra me kaluar
4 nëpër atë territor dhe me kontakt me komandantin Jetullah
5 Qarrin disa herë. Prandaj për shkak të asaj i di, për ndryshe,
6 ai nuk ka referuar për punën e vet apo nuk i ka marrë edhe
7 detyrat nga zona operative e Pashtrikut, por i ka marrë nga --
8 drejtpërdrejtë nga Shtabi i Përgjithshëm, prandaj edhe po e
9 quaj unë batalion special, apo njësi e veçantë, dhe si
10 speciale që ka qenë e lidhë drejtpërdrejtë me komandën e
11 Shtabit të Përgjithshëm.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Brenda Shtabit të
13 Përgjithshëm, kush i lëshonte urdhra këtij komandanti? Kush e
14 komandonte këtë komandant?
15 PË. Ah, nuk muj me thanë tash ky ose ai, por në bazë të
16 parimeve, njësoj, sikurse brigadat që kanë qenë fillimisht të
17 lidhë drejtpërdrejtë me Shtabin e Përgjithshëm, ashtu ka qenë
18 edhe batalioni. Ose edhe më vonë, kur zona ka funksionuar, kanë
19 funksionuar zonat, secila zonë fillimisht i ka raportuar Shtabit
20 të Përgjithshëm, ngjashëm ka vepruar edhe batalioni. Pavarësisht
21 që ka qenë njësi batalioni. Pra, ka funksionuar si njësi e
22 pavarur.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ky batalion i Shtabit të
24 Përgjithshëm ishte njësi i po -- njësitit i policisë ushtarake?
25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ishte një njësit që

2 kishte ushtarë apo jo?

3 PË. Po, po. Ka pas numër të konsiderueshëm ushtarësh. Po jo
4 ush -- policë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me përfaqësi, sa ushtarë ka
6 pasur, nëse e dini?

7 PË. Duhet me u sjell numri i ushtarëve rreth 300, apo 350
8 ushtarë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Funkciononte vetëm në atë
10 zonë përgjegjësie? Pra, në Grejëçic dhe në Llanishtë? Në ato
11 zona që ju vendosët në hartë?

12 PË. Aq sa di unë, e kam prezantuar dhe mendoj që ato i kam
13 dhanë. Tjetër nuk di.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
15 Dëshmitar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje nga
17 Prokuroria plotësuese?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
20 po ju keni pyetje shtesë?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, shumë pak.

22 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, shumë shkurt, kam vetëm disa pyetje të vogla.

25 Lidhen me diçka që thatë dje, kur iu përgjigjët pyetjes së

1 Gjykatësit Mettraux, kur ju pyeti për veprën penale të

2 dezertimit. Të kujtohet që ju pyeti për këtë?

3 PË. Po.

4 PY. Besoj se ju u përgjigjët kështu, që nuk ishit i sigurt

5 nëse dezertimi ishte vepër penale. Në UÇK flasim. Kështu?

6 PË. Jo, kam mujt me u keqkuptue. Dezertimi është vepër penale

7 po realisht -- po e përmendi unë, dje kam qenë pak konfuz, dhe

8 kurrgjë nën stres në momentin kur -- deri sa e kam pas

9 intervistën me Gjykatësin në fjalë.

10 PY. Kuptojmë. Në fakt, këtë doja të sqaroja. Ju keni qenë në

11 armatën jugosllave dhe dua t'ju tregoj disa dispozita të Kodit

12 Penal të ish-Jugosllavisë dhe më thoni, për shembull, neni

13 217.

14 Thuhet: "Një ushtarak që është fshehur për t'ju shmangur

15 shërbimit të detyrueshëm ushtarak, apo që në mënyrë arbitrare

16 largohet nga shërbimi apo nga detyra, dhe nëse nuk kthehet

17 brenda 30 ditësh, apo nuk kthehet brenda të njëjtës periudhë

18 kohore, brenda njësitit dhe shërbimit, dënohet me burgim për

19 një periudhë 6 mujore, por jo më shumë se 5 vjet."

20 Pika 4 e nenit 217 thotë: "Një ushtarak që ikën jashtë

21 vendit dhe qëndron jashtë vendit për të mos kryer shërbimin

22 ushtarak të forcave të armatosura, dënohet me burgim për jo më

23 pak se një vit."

24 Dëshmitar, me që keni qenë pjesë e armatës jugosllave, i

25 njihni këto dispozita?

1 PË. Zoti Avokat, realisht tash po flas në fazën deri sa unë
2 kam qenë në armatë, me siguri i kam njohur dhe shumë bukur
3 bile. Se në mesin e -- gjatë shkollimit, ne krahas lëndëve që
4 i kemi pas profesionale, kemi pas edhe një lëndë "E drejta
5 ushtarake" dhe ndoshta baza që pak a shumë sot më shërben për
6 me -- disa çështje me i lidh në aspektin e jurisprudencës,
7 është prej atëherë. Mirëpo nuk është profesioni jem në
8 aspektin juridik. Këto i kam harru, por megjithatë, në atë
9 periudhë i kam njohur mirë.

10 PY. Dhe një dispozitë tjetër e Kodit Penal të ish-
11 Jugosllavisë, që ka në vitin 1998-1999 në Kodin Penal në fuqi.
12 Thuhet: "Nëse kryen veprën penale që sapa citova, ku
13 përfshihet larg - braktisja e njësitit dhe të shkosh jashtë
14 vendin, në një gjendje lufte apo rrezik të menjëhershëm lufte,
15 kryerësi dënohet me burgim për jo më pak se 5 vjet dhe deri në
16 dënim me vdekje."

17 E dinit ju në atë kohë që nëse braktisje detyrën mund të
18 dënoheshe edhe me vdekje?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, si vetë anëtar i UÇK-së në atë kohë, ju e dinit që
21 dezertimi në fakt ishte një veprë penale e rëndë dhe për këtë
22 mund të dënoheshe në mënyrë të rëndë?

23 PË. Po, pak a shumë kjo nxirret edhe nga teksti i betimit.

24 PY. Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Misetic.

2 Z. Emerson, keni gjë?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Roberts?

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Po kemi pyetje.

8 Ju lutem të nxjerrim në ekran provën materiale me numër
9 P1105.

10 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

11 Z. ELLIS: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, ky është një dokument që ua tregoi dje
13 Gjykatësi Mettraux. Besoj se ju kujtohet kjo. Dëshmitar, që ta
14 konfirmojmë edhe një herë: Përpara ditës së djeshme, ju nuk e
15 kishit parë ndonjëherë këtë dokument, apo jo?

16 PË. Nuk e di a kam parë me Prokurorinë, por para kësaj,
17 domethënë, javën e kalume dhe këtë javë, nuk e kam parë.

18 PY. Dje konfirmuat në përgjigje të pyetjes sime se keni
19 mbajtur kontakte të rregullta me Ekrem Rexhën dhe ai tha që
20 Blerim Kuqi, Nexhmedin Kastrati dhe Ekrem Rexha kanë shkuar në
21 Shtabin e Përgjithshëm me ftesë të Jakup Krasniqit, për
22 qëllime konsultimi. Të kujtohet kjo?

23 PË. Po, kjo qëndron. Prandaj edhe kjo çështje "urdhnesë" pak
24 më bën mua konfuz.

25 PY. Po. Ekrem Rexha nuk ju tregoi ndonjë dokument kur ua

1 përcolli këtë informacion apo jo?

2 PË. Jo, nuk më ka tregu kurrfarë dokumentacioni vetëm ka
3 thënë që "kemi pas një ftesë për konsultim, për me i --
4 bashkërenditje të veprimeve dhe punës në nivel të zonës
5 operative të Pashtrikut". Jo për ndonjë çështje tjetër, por
6 gjërat kanë rrjedh q'asi lloji që Blerimi është ndalë.

7 PY. Gjykatësi Mettraux ju tha se ky dokument është nënshkruar
8 nga Jakup Krasniqi si zëvendëskomandant, por ju këtë dokument
9 nuk e kishit parë më përpara, Dëshmitar, e rrjedhimisht s'e
10 keni parë Jakup Krasniqin me sytë tuaj ta firmosë këtë
11 dokument, apo jo?

12 PË. Jo, jo. Realisht nuk e kam parë dokumentin edhe për shkak
13 të asaj që është kërkuar interpretimi i disa prej dokumenteve,
14 realisht mu më ka bërë me të vërtetë me u ndi keq në këtë, se
15 -- në këtë sallë.

16 PY. Në fakt, ju u ndjetë keq sepse ju kërkuat të spekulonit
17 për dokumente që nuk i kishit parë më përpara apo jo?

18 PË. Pikërisht.

19 PY. E kuptoj. Edhe pak minuta kemi bashkë, dhe do
20 përfundojmë. Ju nuk jeni ekspert daktilogr -- i shkrimit të
21 dorës, apo jo? Kështu nuk ju -- ju nuk mund të na thoni me
22 siguri që kjo është shkrimi i Jakup Krasniqit, apo -- ekspert
23 kaligrafik, më falni.

24 PË. Zoti Avokat, faleminderit që shkruat këtë pyetje, por
25 megjithatë, të gjithë jeni më ekspertë ose jeni ekspertë të

1 lëmisë së jurisprudencës dhe e dini pak a shumë se si bëhet
2 ekspertiza. Sikur unë të kisha këtë aftësi që menjëherë t'i
3 jap përgjigje, është kjo ose ajo, unë do të isha personi numër
4 një në botë. Jo njeri i rëndomtë, një mësues në një -- në një
5 komunë të Suharekës. Prandaj edhe e kam ndjere veten në një
6 pozicion --

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
8 nuk po ju kërkojmë të jepni mendim eksperti, nëse po
9 përgjigjeni për këtë arsye.

10 Z. Ellis, ju lutem, riformulojeni pyetjen, sepse e bëtë
